



Pranuar / Dorezuar Puniljeno/Prodato Received/Delivered	02-06-2022	2	viti god year
Organ /Mësi Organ /Jednica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtimi Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKMESHCK	3231/2022		1/7



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.408/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi Bajraktari-kryetare, Eshref Shabani dhe Jeton Koca-anëtarë si dhe Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.284/2022 të datës 24.03.2022 dhe A.nr.408/2022 të datës 21.04.2022 të parashtruar nga ankuesi me adresë të Komunës së Obiliqit, të bashkuar në një ankesë me numër A.nr.408.2022, në çështjen juridike ‘masës disiplinore’, kundër organit të punësimit/Komuna e Obiliqit, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 01.06.2022, mori këtë:

V E N D I M

- I. **APROVOHET si e bazuar** ankesa me numër A.nr.408/2022 e datës 21.04.2022 e parashtruar nga ankuesi
- II. **SHFUQIZOHET** Vendimi me Nr. IV-27 i datës 25.02.2022 për shqiptimin e masës disiplinore vërejtje ndaj ankuesit nga udhëheqësi i drejtpërdrejt dhe Vendimi me numër XII-95 i datës 24.03.2022 i Komisionit Disiplinor i Komunës së Obiliqit.
- III. **OBLIGOHET** Kryetari i Komunës dhe Udhëheqësi i Njëjesisë së Burimeve Njerëzore në Komunën e Obiliqit, që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nda dita e pranimit të këtij vendimit, të bëjë zbatimin e këtij vendimi, duke bërë kompensimin e pagës së ankuesit të ndaluar sipas vendimit të Komisionit Disiplinor di dhe të bëjë shuarjen e masave disiplinore sipas pikës II të këtij dispozitivi.
- IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ndaj ankuesit i punësuar në Komunën e Obiliqit, sipas Akt emërimit me numër II/05 datës 03.02.2017 në pozitën “Inspektor i Ndërtimit”, më datë 30.11.2021 Udhëheqësi i Inspektionit parashtron kërkesë me numër të referencës 32049 për iniciimin e procedurës disiplinore për shkak të mos përmbushjes së detyrave të punës.

Komisioni Disiplinor i Komunës së Obiliqit me datë 29.12.2021 nxjerr Vendim me numër XII-171 me të cilin vendim ankuesit i shqipton masën disiplinore **“ndalim i 20% të pagës për periudhën kohore prej 5 muajsh”**.

Ankuesi i pa kënaqur me Vendimin me numër XII-171 të datës 29.12.2021 të Komisionit Disiplinor të Komunës së Obiliqit me datë 24.01.2022 parashtroi ankesë me numër të protokollit 301/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 27.01.2022 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankuesit tek Komuna e Obiliqit, ndërsa Këshilli më datë 11.02.2022 ka pranuar përgjigjen në ankesë nga organi i punësimit me shkresat e bashkangjitura të lëndës faqe 1/97.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës më datë 09.03.2022 ka nxjerr Vendim A.nr.53/2022 me të cilin ka Shfuqizuar Vendimin XII-171 të datës 29.12.2021 të Komisionit Disiplinor duke e obliguar të njëjtin që brenda 15 ditësh të shqyrtoj rastin.

Më datë 25.02.2022 udhëheqësi i drejtpërdrejt i ankuesit ka nxjerr Vendim me Nr. IV-27 me të cilin ankuesit i ka shqiptuar masën disiplinore “vërejtje” me arsyetimin për sjellje jo korrekte gjatë orarit të punës me kolegët, mbikëqyrësin dhe publikun, po ashtu nuk diskuton problemet me udhëheqësin e tij të drejtpërdrejtë.

Ankuesi më datë 24.03.2022 kundër kësaj mase ka parashtruar ankesë me Nr.Prot:1568/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Komisioni Disiplinor i Komunës së Obiliqit sipas Vendimit A.nr.53/2022 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 24.03.2022 ka nxjerr Vendim me Nr. XII-95 me të cilin ankuesit i ka shqiptuar masën disiplinore **“ndalim 20% të pagës për periudhën kohore prej 5 muajsh”**.

Ankuesi i pa kënaqur me Vendimin me numër XII-95 të datës 24.03.2022 të Komisionit Disiplinor të Komunës së Obiliqit, më datë 21.04.2022 parashtroi ankesë me Nr. Prot:2280/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës më datë 05.05.2022 ka nxjerr Vendim me Nr. 20/2022 me të cilin ka bërë bashkimin e ankesës A.nr/248 të datës 24.03.22 dhe ankesës A.nr.408/2022 të datës 21.04.2022 të ankuesit për shkak që baza për vendosje dhe faktet janë të njëjta.

**Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova:** Ankesa e ankuesit e datës 24.01.2022 e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me Nr. XII-171 i datës 29.12.2021 i Komisionit Disiplinor të Komunës së Obiliqit; Kërkesën e datës 30.11.2021 për fillimin e procedurës disiplinore ndaj ankuesit; Emailin e datës 03.12.2021 dhe 01.12.2021 nga ankuesi; Emailin e datës 30.11.2021, 01.12.2021, 17.12.2021, 28.12.2021 nga për ankuesin; Procesverbal i seancës së parë të Komisionit Disiplinor i datës 01.12.2021; Procesverbalin e seancës së tretë-pjesa e parë e Komisionit Disiplinor datës 20.12.2021; Procesverbalin e seancës së tretë-pjesa e dytë e Komisionit Disiplinor datës 20.12.2021 dhe 23.12.2021; Procesverbal i seancës së katërt të Komisionit Disiplinor i datës 29.12.2021; Shkresë e datës 08.01.2019; Licenca me Nr. 177; Leje Ndërtimore me Nr.V-773 e datës 14.08.2018; Kontratë Pune për punë dhe detyra specifike e datës 10.10.2018; Procesverbali për kontrollin Inspektues me numër 05 Nr.10 i datës 18.09.2018; Procesverbali për kontrollin Inspektues me

numër 05 Nr.25 i datës 26.10.2018; Procesverbali për kontrollin Inspektues me Nr.00071 i datës 08.02.2019; Procesverbali për kontrollin Inspektues me Nr.000072 i datës 20.02.2019; Procesverbali për kontrollin Inspektues me numër 05 Nr.09 i datës 12.04.2019; Shtojcën 1: Njoftim për fillimin e ndërtimit i datës 23.11.2018; Shtojcën 4/a: Inspektimi i fazave i datës 23.11.2018; Shtojcën 4/b: Inspektimi i fazave i datës 18.02.2020; Shtojcën 4/c: Inspektimi i fazave i datës 12.04.2020; Shtojcën 4/d: Inspektimi i fazave i datës 04.06.2020; Shtojcën 4/e: Inspektimi i fazave i datës 07.11.2020; Shtojcën 4/f: Inspektimi i fazave i datës 12.10.2021; Foto e ndërtimit; Procesverbalin për kontrollin inspektues me Nr. 00021 i datës 12.10.2021; Raporti Final me Nr. XV-209 i datës 14.10.2021; Njoftim me Nr.V-1892 dhe Nr.V-1893 i datës 16.11.2021; Emailin e datës 24.11.2021 për ankuesin; Kërkesën për raporte finale e datës 24.11.2021; Raportin javor i datës 15.10.2021, 12.11.2021, nga ankuesi; Shkresë për bartjen e lëndës për procedim të mëtutjeshëm i datës 10.08.2021; Procesverbalin me numër 05.Nr.22 i datës 02.08.2021; Kontratë mbi qiranë e datës 01.11.2019; Raport i datës 19.08.2021; Emailin e datës 18.02.2022; Emailin e datës 17.01.2022 nga ankuesi; Procesverbal i seancës së parë të Komisionit Disiplinor i datës 07.12.2021; Kërkesë për përgjigje në anesë e datës 27.01.2022; Përgjigje në ankesë e datës 11.02.2022; Vendimin e datës 20.11.202 mbi emërimin e komisionit disiplinor; Akt Emërimin e datës 01.02.2017 në emër të ankuesit; Procesverbal i seancës së dytë të komisionit disiplinor i datës 06.12.2021; Raportin Final me Nr. XV-213 i datës 08.11.2021; Procesverbalin për kontrollin inspektues me Nr.00025 i datës 28.10.2021; Procesverbalin për kontrollin inspektues me Nr. 00591 i datës 30.04.2021; Procesverbalin për kontrollin inspektues me Nr.00343; Shtojca 1: Njoftimin për fillimin e ndërtimit i datës 29.09.2020; Shtojcën 2: Inspektimi i Lokacionit i datës 25.09.2020; Shtojcën 3: Kërkesën për inspektim e datës 25.09.2020; Shtojcën 4/a: Inspektimi i fazave i datës 29.09.2020; Shtojcën 4/b: Inspektimi i fazave i datës 29.09.2020; Shtojcën 4/c: Inspektimi i fazave i datës 29.09.2020; Shtojcën 4/d: Inspektimi i fazave i datës 30.04.2021; Shtojcën 4/a: Inspektimi final i datës 30.04.2021; Vendimin mbi emërimin e organit mbikëqyrës të vend ndërtimi MEDRUPLAST; Ankesa e datës 24.03.2022 e parashtruar nga ankuesi me Nr. Prot:1568/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me Nr.IV-27 e datës 25.02.2022 për shqiptimin e masës disiplinore vërejtje; Emailin e datës 17.03.2022 nga ankuesi; Raporti javor i datës 11.03.2022; Emailin e datës 16.03.2022 nga ankuesi; Emailin e datës 14.03.2022 nga ankuesi; Emailin e datës 10.03.2022 nga ankuesi; Emailin e datës 01.03.2022 nga ankuesi; Emailin e datës 24.02.2022 nga ankuesi; Emailin e datës 23.02.2022 për ankuesin nga Përgjigje e datës 12.02.2021 nga Inspektorët e Ndërtimit; Emailin e datës 15.02.2022 nga ankuesi; Emailin e datës 14.02.2021 nga për ankuesin; Emailin e datës 09.02.2022 nga ankuesi; Emailin e datës 03.02.2022 nga ankuesi; Njoftimin e datës 22.01.2022 nga ankuesi; Emailin e datës 20.01.2022 nga ankuesi; Emailin e datës 05.01.2022 nga ankuesi; Përshkrimi i detyrave të punës Inspektor i Ndërtimtarisë; Ankesa e datës 21.04.2022 e parashtruar nga ankuesi me Nr. Prot:2280/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me numër XII-95 të datës 24.03.2022 të Komisionit Disiplinor të Komunës së Obiliqit; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 05.05.2022; Përgjigjen në ankesë e datës 17.05.2022; Procesverbalin e Komisionit Disiplinor i datës 17.03.2022 dhe 22.03.2022; Vendimin me Nr. 20/2022 i datës 05.05.2022 për bashkimin e ankesave nga Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me numër A.ntr.53/2022 i datës 09.03.2022 i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, dhe ka konstatuar se ankesa e ankuesit, **është e bazuar, sepse:**

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesit i cili pretendon se masa disiplinore vërejtje e shqiptuar nga udhëheqësi i tij i drejtpërdrejt dhe masa disiplinore e shqiptuar nga Komisioni Disiplinor i Komunës së Obiliqit janë nxjerr në kundërshtuam me dispozitat ligjore në fuqi, duke përbërë shkelje të dispozitave procedurale, konstatim të gabuar të gjendjes faktike dhe shkelje të ligjit material.

Fillimisht Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka shqyrtuar ligjshmërinë e Vendimit me Nr. IV-27 të datës 25.02.2022 të Udhëheqshi të Inspektionit me të cilin ankuesit i ka shqiptuar masën disiplinore "vërejtje", dhe ka konstatuar që kjo masë ankuesi i është shqiptuar me arsyetim që ka sjellje jo të mira me kolegët, mbikëqyrësin dhe publikun brenda apo jashtë orarit zyrtar të punës dhe i njëjti gjatë ushtrimit të detyrave për probleme të natyrës së punës i drejtohet personave të tjerë jo mua si udhëheqës duke mos më njoftuar për problemet siç është edhe pretendimi i tij se është duke i munguar një folder me material që lidhen me veprimet e tij.

Bazuar na shkresat e lëndës, konkretisht ankuesi përmes emailit të datës 09.02.2022 ka kërkuar që të jepet nga një kopje e aktvendimeve të vitit 2021 që lidhen me vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2021 e që kundër tij ka parështur ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke theksuar që në folderin që ka nuk ekziston i tëri, ndërsa udhëheqësi i drejtpërdrejt i ankuesit më datë 14.02.2022 ka njoftuar ankuesin që **"...unë nuk kuptoj se çka keni thënë se folderi nuk ekziston me tërë dokumentacionin"**, ndërsa ankuesi përmes emailit më datë 15.02.2022 ka njoftuar udhëheqësin e tij të drejtpërdrejt që **"...lidhur me disa prej aktvendimeve të vitit 2021 të cilat më mungojnë në folderin tim 2021, nuk kam tjetër shpjegim..."**.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se ankuesi në asnjërin nga emaillet si të datës 09.02.2022 po ashtu edhe të datës 15.02.2022 nuk ka thënë që mungon komplet dokumentacioni sepse fjalía "nuk është i tëri" nuk nënkupton që mungon komplet dokumentacioni, kjo nënkupton që një pjesë e tij mungon këtë e ka sqaruar ankuesi edhe në emailin e datës 15.02.2022.

Gjatë shqyrtimit të ligjshmërinë së akti administrativ, gjegjësisht Vendimit me Nr. IV-27 të datës 25.02.2022, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se udhëheqësi i drejtpërdrejt i ankuesit, nuk ka arritur që me asnjë provë të vetme që argumentoj faktin se cilat janë veprimet e ankuesit që ai ka sjellje të parregullta me mbikëqyrësin, kolegët, vartësit dhe me publikun dhe kryerjen e veprimeve që cenojnë nëpunësit civil, institucion apo shërbimin civil në tersi brenda ose jashtë orarit zyrtar, sepse në prova të lëndës nuk ka asnjë deklaratë nga ndonjë koleg i ankuesit i cili ka paraqitur ndonjë shqetësim për sjellje të ankuesi, po ashtu nuk ka asnjë dëshmi që dikush nga publiku të ketë shprehur pakënaqësi lidhur me sjelljet e ankuesit.

Në kuptim të kësaj, Ligji Nr. 06/L-114 për Zyrarët Publikë, konkretisht neni 48 paragrafi 2 ka përcaktuar se: **"Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë detyrohet të fillojë procedurën disiplinore mbi bazën e fakteve konkrete dhe të provuara për shkeljen e detyrimeve nga nëpunësi civil"**, si rrjedhojë udhëheqësi i drejtpërdrejt i ankuesit nuk ka marr parasysh këtë dispozitë ligjore me rastin e shqiptimit të kësaj mase disiplinore, po ashtu nuk janë plotësuar kushtet për ekzistimin e elementeve disiplinore të përcaktuar me nenin 45 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrarët Publikë, i cili përcakton se: **"Përgjegjësia disiplinore është moszbatimi apo zbatim jo i duhur i detyrave të punës dhe detyrimeve të tjera ligjore, që përmban elementet si në vijim: 1.1. "ekzistimin e veprimit të paligjshëm apo mosveprimit;" 1.2. kryerjen e veprimit me faj apo mosveprimit; 1.3. ndodhja e pasojës 1.4. ndodhja e dëmit; dhe 1.5. lidhjen shkakësore ndërmjet veprimit të kryer dhe pasojës/dëmit"**, elemente këto që duhet plotësuar kumulativisht në mënyrë që të ekzistoj përgjegjësia disiplinore, e në rastin konkret të ankuesit, udhëheqësi i drejtpërdrejt me rastin e shqiptimit të masës disiplinore nuk ka arritur të bëjë vlerësimin e tyre, duke mos marr për bazë dispozitat e nenit 50 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrarët Publik dhe nenit 13 paragrafi 4 të Rregullores (QRK) Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrarëve Publikë, rrjedhimisht pretendimet ankimore të ankuesit kundër Vendimit me Nr. IV-27 të datës 25.02.2022 për shqiptimin e masës disiplinore vërejtje nga udhëheqësi i drejtpërdrejtë, janë të bazuara.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, gjatë shqyrtimit të provave të lëndës, ka konstatuar që ankuesi më datë 08.11.2021 ka përgatitur raportin final për objektin afarist "NTP Medruplast", z.k Llazarevë me Nr. XV-213 duke konsideruar se të gjitha dokumentacionet përkatëse janë pjesë e lëndës, si rrjedhojë në prova të lënda ekziston Procesverbali për Kontrollin Inspektues me Nr. 00025 i datës 28.10.2021, Procesverbali me Nr. 00591 i datës 30.04.2021, Procesverbali për kontrollin inspektues me Nr. 00343, Njoftimin për fillimin e ndërtimit i datës 29.09.2020; Shtojca 2: Inspektimi i lokacionit e datës 25.09.2020, Shtojca 3: kërkesë për inspektim i datës 25.09.2020, Shtojca 4/a: inspektimi i fazave 29.09.2020, Shtojca 4/b: inspektimi i fazave i datës 29.09.2020; Shtojca 4/c: Inspektimi i fazave i datës 29.09.2020; Shtojca 4/d: inspektimi i fazave i datës 30.04.2021; Shtojca 4/f: inspektimi final i datës 30.04.2021, po ashtu ankuesi më datë 14.10.2021 ka përgatitur raportin final për objektin afarist "SHKABAJ" SH.P.K me Nr. XV-209, ku në prova të lëndës ekzistojnë Procesverbali për kontrollin Inspektues me Nr.00460 i datës 02.08.2021, Procesverbali për kontrollin inspektues me numër 05.Nr.10 i datës 18.09.2018, Procesverbali me numër 05.Nr.25 i datës 26.10.2018, Procesverbali për kontrollin inspektues me Nr. 000071 i datës 08.02.2019, Procesverbali për kontrollin inspektues me Nr. 000072 i datës 20.02.2019, Procesverbali për kontrollin inspektues me Nr.000244 i datës 12.04.2019, Njoftim për fillimin e ndërtimit, Shtojca 4/1: inspektimi i fazave i datës 23.11.2018, Shtojca 4/b: inspektimi i fazave i datës 12.04.2020, Shtojca 4/c: Inspektimi i fazave i datës 12.04.2020, Shtojca 4/d: Inspektimi i fazave i datës 04.06.2020; Shtojca 4/e: Inspektimi i fazave i datës 07.11.2020 dhe Shtojca 4/f: Inspektimi i fazave i datës 12.10.2021. Kështu që gjatë shqyrtimit të këtyre provave, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se disa nga provat (shtojcat) e lartcekura janë të pa nënshkruara nga inspektorët, mirëpo në këto rast ankuesi nuk ka qenë në cilësinë e inspektorit, këtë e ka theksuar edhe Komisioni Disiplinor i Komunës së Obiliqit në Vendimin me Nr. XII-95 të datës 24.03.2022, duke theksuar që: "...zyrtari z. *nuk ka qenë i kyçur në fillim të inspektimit të lëndëve në fjalë dhe të njëjta i janë dorëzuar të pa kompletuar nga inspektorët e tjerë, komisioni vlerëson se zyrtarin në fjalë nuk e bënë më pak të përgjegjshëm...*".

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se në provat e lëndës, ekzistojnë dokumentacionet respektivisht janë përdoruar shtojcat të cilat kërkohen me nenin 8 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr.05/2017 për Mbikëqyrje Inspektuese dhe Procedurën për Lëshimin e Certifikatës së Përdorimit, në këtë rast edhe ankuesi me rastin e përgatitjes së raporteve finale ka dorëzuar të njëjtat edhe pse nuk ka qenë që nga fillimi i kyçur në këtë proces, andaj sipas Kolegjit për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, meqë Komisioni Disiplinor i Komunës së Obiliqit ka konstatuar që ankuesi nuk ka qenë i kyçur që nga fillimi në këtë proces, atëherë si mund të ndëshkohet ankuesi për një proces në të cilin nuk ka marr pjesë e ndaj personave të tjerë që kanë marr pjesë në proces dhe nuk kanë kryer detyrat e punës mos të ndërmerren asnjë veprim.

Gjatë shqyrtimit të Vendimit me numër XII-95 të datës 24.03.2022 të Komisionit Disiplinor të Komunës së Obiliqit, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se arsyetimi i këtij vendimin është kundërthënës dhe kontradiktor, për fatin që në njërin anë ka konstatuar që ankuesi nuk ka marr pjesë në tërë fazat inspektuese ndërsa në anën tjetër për të gjitha e ka bërë fajtor ankuesin, po ashtu komisioni disiplinor nuk ka shqyrtuar në mënyrë të drejtë provat e lëndës, konkretisht raportet javore të ankuesit, si rrjedhojë komisioni disiplinor ka vepruar në kundërshtim me nenin 11 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1. të Rregullores Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publik, i cili përcakton se: "*1. Komisioni disiplinor ka këto kompetenca: 1.1. bënë shqyrtimin e fakteve dhe provave të paraqitura*".

Po ashtu Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, vlerëson se inicimi i procedurës disiplinor ndaj ankuesit, është bërë pa u shqyrtuar saktë faktet konkrete, të përcaktuar me nenin 48 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, i cili përcakton se: "*Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë detyrohet të fillojë procedurën disiplinore mbi bazën e fakteve konkrete dhe të provuara për shkeljen e detyrimeve nga*

*nëpunësi civil*”, rrjedhimisht për përcaktimin e masës disiplinore të zbatueshme, mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë ose komisioni disiplinor bazohet në: **1.1. shkaqet, rrethanat e kryerjes së shkeljes, rëndësinë dhe pasojat e saj; 1.2. shkallën e fajësisë; 1.3. ekzistencën e masave të tjera disiplinore të mëparshme të pashlyera; 1.4. përpjekjet e mëparshme të nëpunësit për shmangien apo kufizimin e dëmit**”, siç parashihet me nenin 50 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, në këtë kuptim Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se as mbikëqyrësi i drejtpërdrejt i ankuesit e as komisioni disiplinor nuk kanë pasur parasysh këto dispozita.

Bazuar në të gjitha provat e lëndës, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, vlerëson se nuk janë plotësuar kushtet për ekzistimin e elementeve disiplinore të përcaktuara me nenin 45 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, i cili përcakton se: **“Përgjegjësia disiplinore është moszbatimi apo zbatim jo i duhur i detyrave të punës dhe detyrimeve të tjera ligjore, që përmban elementet si në vijim: 1.1. “ekzistimin e veprimit të paligjshëm apo mosveprimit;” 1.2. kryerjen e veprimit me faj apo mosveprimit; 1.3. ndodhja e pasojës 1.4. ndodhja e dëmit; dhe 1.5. lidhjen shkakësore ndërmjet veprimit të kryer dhe pasojës/dëmit**”, elemente këto që duhet plotësuar kumulativisht në mënyrë që të ekzistoj përgjegjësi disiplinore, e në rastin konkret të ankuesit, komisioni disiplinor i Komunës së Obiliqit me rastin e shqiptimit të masës disiplinore nuk ka arritur të bëjë vlerësimin e tyre, duke mos marr për bazë dispozitat e nenit 50 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publik dhe nenit 13 paragrafi 4 të Rregullores (QRK) Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë, andaj Vendimi me Nr. XII-95 i datës 24.03.2022 i Komisionit Disiplinor i Komunës së Obiliqit, është në kundërshtim me nenin 48 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2, 1.3, 1.4 dhe 1.5 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshëm Administrative, ndërsa arsyetimi i Vendimit me numër XII-95 të datës 24.03.2022 të Komisionit Disiplinor i Komunës së Obiliqit, është në kundërshtim me paragrafin 2 të nenit 48 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshëm Administrative, i cili përcakton se: **“Një arsyetim që është dukshëm i pamjaftueshëm, i paqartë, kundërthënës apo i pakuptueshëm, është i barabartë me mungesën e tij**”, kështu që i njëjti është i paligjshëm në kuptim të nenit 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3, 1.5, 1.6 dhe 1.7 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshëm Administrative, kështu që pretendimet ankimore të ankuesit kundër Vendimit me numër XII-95 të datës 24.03.2022 të Komisionit Disiplinor të Komunës së Obiliqit, janë të bazuara.

Si u tha më lartë, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se obligohet Kryetari i Komunës dhe Udhëheqësi i Njësisë së Burimeve Njerëzore i Komunës së Obiliqit, që në pajtim me dispozitivin e këtij vendimi të bëjë kompensimin e ndalimit të pagës sipas Vendimit me numër XII-95 të datës 24.03.2022 të Komisionit Disiplinor të Komunës së Obiliqit dhe të bëjnë shuarjen e masës disiplinore ndaj ankuesit në pajtim me këtë vendim.

Me dispozitat e nenit 21 paragrafit 1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, është përcaktuar se: **“Vendimi i Këshillit është vendim administrativ i formës së prerë dhe zbatohet nga zyrtari i nivelit të lartë drejtues ose personi përgjegjës i institucionit që e ka marrë vendimin e parë ndaj palës**”, ndërsa me dispozitat e nenit 24 paragrafit 1 të këtij ligji është përcaktuar se: **“Në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit sipas nenit 21 të këtij ligji, Kryetari i Këshillit nxjerr vendim për ndalimin e 50% të pagës mujore për personin përgjegjës, deri në zbatimin e vendimit të Këshillit**”.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda me numër A.nr.408/2022

**Avdyll BEKTESHI**

Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional

**Malsore GASHI-BAJRAKTARI**

Kryetare e Kolegjit



**Vendimi i dërgohet**

- *Ankuesit*
- *Kryetarit të Komunës së Obiliqit;*
- *Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Obiliqit dhe*
- *Arkivit të KPMSHCK-së.*

